

**Art, kulturë, muzikë, argëtim, aventurë e plot surpriza, për ata që e duan këtë qytet!**



***Gjatë muajit Mars: Një atraksion i ri iu shtua Tiranës: Pazari i Ri, i inaguruar në Ditën e Verës. Evente të tjera: Festimet e 8 Marsit; Cup Song- Shqipëria fituese e Rekordit Guinness, rekomandime për vizitorët e muajit Mars në Tiranë dhe plot ngjarje të tjera kulturore.***

***Vijon Konkursi i Fotografisë #TiranaSpring. Fituesit shpallen në fillim të Majit. Çmimet: Fitues i vendit të parë: Një darkë në hotel/restorant Xheko Imperial***

***Fitues i vendit të dytë: tur një ditore aventurë në rrethinat e Tiranës  
Çmimi i tretë: dy bileta kinemaje, Film 3D në Cineplexx***

**Çfarë ofron Marsi në Tiranë**

**Festa e Gruas, si u festua**

**Dita e Verës në Tiranë**



Muaji Mars si sinjalizues i pranverës



8 Marsi është Dita Botërore e



14 Marsi është një ditë festive e

pritet me shumë gëzim në Tiranë. Dita fillon e bëhet më e gjatë dhe njerëzit kanë më shumë mundësi për aktivitete argëtuese. Shpërthimi i luleve dhe pemëve e bën Tiranën më të bukur. Pranvera është një ndër stinët që ka numrin më të lartë të vizitorëve në Tiranë dhe për këtë ne listojmë rekomandimet tona se çfarë vizitohet në Tiranë gjatë muajit Mars.

Gruas. Tematika e këtij vit është #GuxoPërTëNdryshuar, dhe një sërë aktivitesh do të organizohen në të gjithë vendet e botës. Në fakt kjo ditë shërben për të festuar dhe përkujtuar përpjekjet e pafundme të grave në të gjithë botën. Gratë shqiptare nuk shkojnë në protesta për të kërkuar të drejtat e tyre nga qeveria. Ata e festojnë këtë ditë si "Ditën e tyre të lirisë dhe zgjedhin të argëtohen në restorante e bare.

veçantë në Shqipëri, ku nuk festohet në asnjë vend tjetër të botës. Quhet Dita e Verës edhe pse festohet ardhja e stinës së Pranverës. Dita e Verës në Tiranë ishte një festë gjigande dhe përfshiu gjithë lagjet e qytetit. Ishte bukur të shihje fytyra fëmijësh teksa gëzonin me njëri-tjetrin. Qendra e festimeve ishte Pazari i Ri, por gjetashtu bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Parku Rinia, Parku i Liqenit etj.

### Bienalja 2-të e Akuarelit Ndërkombëtar në Tiranë



Shoqata Ndërkombëtare e Akuarelit "IWS Albania" dhe Organizata Jofitimprurëse WIZart organizuan "Bienalen 2-të të Akuarelit Ndërkombëtar në Tiranë" që u hap në 12 Mars në Tiranë, në Muzeun Historik Kombëtar. Bienalja mbledhi 400 piktorë nga 65 vende, dhe mbi 400 punime të pranishmit panë demonstrime drejtpërsëdrejti nga mjeshtrat më të njohur në botë si Liu Yi, La Fe, Amit Kapoor, Atanur Dogan dhe shumë të tjerë.

### Cup Song, Shqipëria në Guinness



Në datë 25 Mars tek bulevardi "Zogu I", të rinj nga shkolla të ndryshme, performuan në një organizim madhështor me kupa plastike këngën Cup Song, duke e futur Shqipërinë në Rekordet Guinness. Nën rritmet e këngës "të rri apo të iki?" +2016 veta formuan emrin ALBANIA. Përveç madhështisë së aktivitetit, muzikës së bukur dhe sinkronizimit perfekt të pjesëmarrësve, Shqipëria mori vëmendje botërore! Ky event përcolli pozitivitet, harmoni dhe një lajm të mirë nga Shqipëria për Botën.

### EVENTE prill



- Run For Autism Albania. Event për rritjen e ndërgjegjësimit për Autizmin në Liqenin Artificial të Tiranës. (2 prill)
- "Tirana Equestrian Day" – 22 Prill, në aneksin para Stadiumit "Selman Stërmasi".
- Dita e Tokës festohet në të gjithë botën më 22 Prill. Aktivitete të shumta te Liqeni
- Dita Ndërkombëtare e Vallëzimit – 29 Prill, Parku Rinia.
- Fundi i Konkursit #TiranaSpring (30 prill)
- Çfare te besh ne prill në Tiranë.

Për më shumë artikuj unikë gjatë gjithë muajve klikoni në: <http://www.visit-tirana.com/sq/lajme>  
Visit Tirana Rr. "Sami Frashëri", Nd.30, H.2, Ap.8, Tiranë

Tel: +355 4 5800419, Email: [contact@visit-tirana.com](mailto:contact@visit-tirana.com); Web: [www.visit-tirana.com](http://www.visit-tirana.com)

Follow us:   